



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

Nr. Ref: AKSP-2/2015

## **Akademia e Kosovës për Siguri Publike**

shpall

### **K O N K U R S**

Për zgjedhjen e **një mësimdhënësi të rregullt** në Fakultetin e Sigurisë Publike, për grup lëndësh:

- Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut;
- E drejta diplomatike dhe konsullore;
- Rreziqet dhe kërcënimet transnacionale;

Mësimdhënësi do të punojë me orar të plot (40 orë në javë), do të angazhohet për mësimdhënie akademike, kërkime shkencore - mësimore, mësimdhënie në trajnime si dhe në zhvillimin e kurikulave.

Zgjedhja e mësimdhënësit do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 26/2013 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kandidatet që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente: kërkesën me biografi, kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar, certifikatën e lindjes, ndërsa ata të cilët janë duke punuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Kosovë duhet ta paraqesin edhe vendimin e zgjedhjes së fundit, dëshmitë për publikimet shkencore dhe profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë.

Njohja e gjuhës angleze apo ndonjë gjuhë tjetër të huaj, është përparësi për aplikantët. Kandidatet që kanë doktoruar, magjistruar ose që kanë mbaruar master jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në gazetë, respektivisht deri me datën 22.04.2015, në ora 16:00.

Adresa: Rr. Gjergj Kastrioti Skënderbeu - 42000 Vushtrri-Kosovë

Tel: 028 590 070, ext 210

Web: [www.aksp-rks-gov.net](http://www.aksp-rks-gov.net)

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike -Vushtrri, ndërtesa e re administrative, zyra nr. 01. Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

*Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ofron kushte të përshtatshme për kërkime dhe hulumtime shkencore me qëllim të arritjes së rezultateve konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Andaj inkurajohen të aplikojnë kandidat me thirrje shkencore PhD, në fushën e kërkuar.*

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë:

[www.aksp-ks.net](http://www.aksp-ks.net)